

KËRKESË
Nr. 5549/4, datë 17.10.2016
PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Energjisë dhe Industrisë shpall kërkesën për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtshme të tipit “ndërtim, tokë bujqësore arë, truall, kullotë” që preken nga “Ndërtimi i Nënstacionit 110/20 kV Gjiri i Lalzit, Durrës”.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është “OSHEE” sh.a., Tiranë.

Me anën e këtij publikimi në shtyp, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet, pasurisë që dëmtohet dhe masën e kompensimit përkatës të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë për secilin pronar sipas listës emërore të mëposhtme. Brenda 15 ditëve nga data e fundit e publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse pranë Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË
SË ENERGJISË DHE INDUSTRIË
Koli Bele

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, PËR NDËRTIMIN E
NËNSTACIONIT 110/20 kV GJIRI I LALZIT DURRËS
FSHATI KURATEN, NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM

Nr.	Pronari	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji	Sipërfaqja	Çmimi	Vlera	Shënime
1	Thoma Çuni	2332	242/2	arë	384.3	397	152 567.1	Konfirmim nga ZVRPP-ja
2	Shtet	2332	242/1	kullotë	3615.7			Konfirmim nga ZVRPP-ja